

**AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA**

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE  
VITI 2026**

Nr. Rend.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
1.	06.01.2026	<p><b>Kërkesë për informacion.</b></p> <p><b>1.Si i kategorizon dhe i vlerëson AAPSK provat materiale?</b></p>	08.01.2026	<p>Përhëndetje,</p> <p>Gjeni bashkëlidhur informacionin e kërkuar.</p> <p>Në bazë të Ligjit nr. 34/2019, pasuritë e sekuestruara ndahen sipas natyrës së tyre në: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, shuma monetare, aksione/subjekte tregtare dhe prova materiale.</p> <p>Provat materiale përfshijnë mallra, pajisje, metale, sende me vlerë dhe materiale të sekuestruara në kuadër të procedimeve penale.</p> <p>Vlerësimi bëhet rast pas rasti, nga ekspertë të licencuar ose përmes çmimeve referencë apo vlerësimit sipas faqeve në internet, si dhe gjatë fazave të ankandeve publike nga ekspertët përkatës të fushës, në varësi të llojit të pasurisë. Gjithmonë ky vlerësim i</p>	Me email	Pa pagesë



				<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pretendime nga palë të treta mbi pronësinë.</li> <li>• Hipoteka, barrë tatimore apo kontrata ekzistuese.</li> <li>• Vendim përfundimtar gjyqësor që urdhëron kthimin e pronës, duke krijuar detyrim për kompensim nëse prona është dëmtuar.</li> <li>• Uzurpimi i pronës.</li> <li>• Shfrytëzim pa kontratë të rregullt.</li> <li>• Konflikte pronësie mes bashkëpronarëve.</li> <li>• Ndërtim apo ndërhyrje pa leje në pronë.</li> <li>• Humbja e vlerës monetare për shkak të inflacionit.</li> </ul> <p><b>2. Rreziqet kryesore për pasuritë e luajtshme janë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rreziku i amortizimit për automjetet, për pajisjet teknologjike dhe humbja e vlerës së objekteve.</li> <li>• Rreziku i skadimit dhe prishjes së mallrave të konsumit të përditshëm.</li> <li>• Rreziku i dëmtimit ose zhdukjes, i vjedhjes ose humbjes të pasurive gjatë ruajtjes.</li> <li>• Rënie e çmimit të tregut para shitjes.</li> <li>• Pretendimet nga palë të treta për pronësinë.</li> </ul>	
--	--	--	--	---	--

				<ul style="list-style-type: none"><li>• Vendim gjyqësor për kthimin e pasurisë, duke kërkuar që ajo të jetë e ruajtur në gjendje të mirë.</li></ul> <p><b>3. Rreziqet kryesore për pasuritë e luajtshme janë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Rreziku i humbjes së vlerës inflacioni (Nëse mjetet monetare mbahen për një kohë të gjatë, ato mund të humbin fuqi blerëse për shkak të inflacionit).</li></ul> <p><b>4. Rreziqet kryesore për aksione/subjekte tregtare janë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Rreziku i humbjes së vlerës së aksioneve nga luhatjet e tregut, humbjet financiare të shoqërisë dhe rënia e reputacionit të biznesit pas sekuestrimit.</li><li>• Padi nga kreditorët.</li></ul> <p><b>5. Rreziqet kryesore për prova materiale janë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Rreziku i dëmtimit fizik (armë, pajisje, dokumente).</li><li>• Rreziku i degradimit, prishje e mostrave biologjike ose materiale të ndjeshme.</li><li>• Ruajtje në kushte jo të përshtatshme.</li><li>• Rreziku i humbjes ose zhdukjes.</li></ul>	
--	--	--	--	---	--

		<p><b>4.Cilat lloje dominojnë në portofol?</b></p>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vjedhje ose manipulim.</li> </ul> <p>Ligji 34/2019 ka forcuar mekanizmat e inventarizimit, sigurimit dhe shitjes së hershme për të minimizuar këto rreziqe duke sanksionuar në ligj procedura më të qarta për regjistrimin dhe dokumentimin e pasurisë, duke obliguar ruajtjen e saj në kushte të sigurta dhe transparente, si dhe duke lejuar shitjen paraprake të pasurive që rrezikojnë të zhvlerësohen ose të shkaktojnë kosto të larta mirëmbajtjeje, me qëllim ruajtjen e vlerës ekonomike dhe mbrojtjen e interesit publik.</p> <p>Sipas praktikës së administrimit nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në portofolin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara zakonisht dominojnë:</p> <p>Pasuritë e paluajtshme apartamentet, tokat (urbane dhe bujqësore), godinat e biznesit dhe objektet hoteliere. Këto pasuri kanë vlerën më të lartë monetare krahasuar me kategoritë e tjera.</p> <p>Më pas dominojnë pasuritë e luajtshme (automjetet, makineri dhe pajisje</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<b>Si administrohen këto pasuri?</b>	<p>elektronike). Shumat monetare dhe prova materiale të tipit bizhuteri.</p> <p>Administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) bëhet sipas <b>Ligjit Nr. 34/2019</b> dhe ndryshon në varësi të natyrës së pasurisë.</p> <p>(A) Për pasuritë e paluajtshme dhe ato të luajtshme, ato mund:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• të jepen me qira përmes procedurave transparente;</li><li>• të përdoren nga institucione publike;</li><li>• të mbeten në ruajtje nëse ka konflikt juridik;</li><li>• të jenë objekt i procedurave për largimin e uzurpuesve.</li><li>• Në rast të statusit të paqartë pronësie, administrimi vazhdon pa cenuar të drejtat e palëve deri në vendim përfundimtar gjyqësor.</li></ul>		
--	--	--------------------------------------	---	--	--

		<p>LLOGARITË BANKARE / SHUMAT MONETARE</p> <p><b>A i administron realisht AAPSK këto shuma?</b></p>	<p>(B) Për shumat monetare dhe aksionet/subjekte, ato mund:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të vendosen në depozitë bankare;</li> <li>• Shumat monetare mund të konvertohen për të mos humbur vlerën e tyre për shkak të inflacionit ose luhatjeve valutore;</li> <li>• Monitorohen rregullisht për të parandaluar humbjet ose keqpërdorimin;</li> <li>• Administratorët që emërohen të përkohshëm në subjektet tregtare marrin vendime të kontrolluara për operacionet dhe financat e kompanisë, për të ruajtur vlerën dhe aktivitetin ekonomik.</li> </ul> <p>Po. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) në zbatim të <b>Ligjit Nr. 34/2019</b> ka në administrim të saj edhe pasuritë shumat monetare të sekuestrua apo konfiskuara subjekteve të ndryshëm.</p> <p>Sipas Ligjit 34/2019, shumat monetare depozitohen në llogari të posaçme dhe nuk qëndrojnë thjesht të ngrira.</p>		
--	--	---	--	--	--

		<p><b>Si raportohen këto shuma?</b></p>		<p>Shumat monetare depozitohen në llogari bankare të veçanta zyrtare në emër të AAPSK.</p> <p>Pasuritë e luajtshme, në formë të mjeteve monetare, investohen në bono thesari ose depozitohen në llogari bankare të caktuara.</p> <p>Çdo lëvizje dokumentohet dhe kontrollohet për të parandaluar keqpërdorimin.</p> <p>Përdoren vetëm për shpenzime të administrimit ose sipas vendimeve të gjykatës.</p> <p>AAPSK mund të ndërmarrë edhe masa të konvertimit ose investimit të përkohshëm në mënyrë të sigurt për të ruajtur vlerën.</p> <p>Shumat monetare që administron Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara raportohen sipas <b>Ligjit Nr. 34/2019</b> në mënyrë të <b>detajuar, transparente dhe periodike</b></p> <p>Raportohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Stock” (gjendja në fund të vitit);</li> <li>• “Flow” (të ardhurat gjatë vitit).</li> </ul>		
--	--	---	--	---	--	--

		<p><b>Si shmanget humbja nga inflacioni?</b></p> <p>PROVAT MATERIALE</p> <p><b>Çfarë përfshin praktikisht kjo kategori?</b></p>	<p>Kjo shmang numërimin e dyfishtë dhe garanton transparencë.</p> <p>Ligji lejon depozitim në valuta më të qëndrueshme, depozita me afat të shkurtër ose llogari bankare me interes të garantuar për ruajtjen e vlerës monetare.</p> <p>Kategoria e <b>provave materiale</b> në kontekstin e administrimit nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfshin <b>të gjitha objektet fizike që kanë rëndësi si prova në një procedurë penale ose gjyqësore</b>. Praktikisht, kjo kategori mund të përfshijë:</p> <p>Pajisje elektronike, automjete, objekte kriminale (armë etj), dokumente identiteti dhe prova të shkruara, mostra biologjike ose materiale (çdo send tjetër i vlerësuar nga organi akuzës).</p>		
--	--	---	--	--	--



		<p>SUBJEKTE TREGTARE / AKSIONE</p> <p><b>Si administrohet një shoqëri e sekuestruar?</b></p>		<p>për asgjësim ose nxjerrje jashtë përdorimit, sipas ligjit.</p> <p>Në rast administrimi të zakonshëm, rast pas rasti vlerësimet bëhen edhe nga administrator i pasurisë sipas referencave të tregut apo faqeve WEB.</p> <p>Administrimi i një <b>shoqërie të sekuestruar</b> nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara bëhet sipas <b>Ligjit Nr. 34/2019</b> dhe përfshin masa të veçanta për të ruajtur vlerën ekonomike dhe funksionimin e Shoqërisë Tregtare.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• AAPSK emëron një <b>administrator të përkohshëm</b> me eksperiencë në menaxhimin e biznesit.</li> <li>• Administratori ka detyrë të mbajë funksionimin normal të shoqërisë, pa ndërhyrë në pronësinë finale.</li> <li>• Regjistrohen të gjitha asetet, detyrimet, kontratat dhe pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të shoqërisë.</li> <li>• Bëhet vlerësim financiar i kompanisë për të përcaktuar <b>vlerën ekonomike dhe potencialin për të gjeneruar të ardhura.</b></li> </ul>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>Çfarë ndodh me fitimet gjatë administrimit?</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendimet kryhen në mënyrë të kontrolluar për të <b>ruajtur vlerën dhe stabilitetin e biznesit.</b></li> <li>• Administratori raporton rregullisht tek AAPSK për <b>gjendjen financiare dhe operacionale</b> të shoqërisë.</li> <li>• AAPSK monitoron vendimet për të siguruar <b>ligjshmëri, transparencë dhe mbrojtje të interesit publik.</b></li> </ul> <p>Gjatë administrimit të një <b>shoqërie të sekuestruar</b>, fitimet që gjeneron Shoqëria Tregtare <b>administrohen nga AAPSK</b> me qëllim ruajtjen e vlerës ekonomike dhe mbulimin e shpenzimeve të administrimit. Fitimet depozitohen në fond të posaçëm dhe mbeten të bllokuara deri në vendimin përfundimtar të formës së prerë.</p> <p>Nëse vendimi i gjykatës i formës së prerë vendos konfiskimin e shoqërisë tregtare → fitimet kalojnë në pronësi të shtetit.</p> <p>Nëse vendimi i gjykatës i formës së prerë vendos kthimin e shoqërisë tregtare → fitimet i rikthehen subjektit.</p>		
--	--	--	--	--	--



		<p><b>Si janë marrëdhëniet me prokurorinë?</b></p> <p><b><u>Nisma ligjore të AAPSK</u></b></p> <p><b>Projektligji për ndryshime në Ligjin nr. 34/2019</b></p>		<p>sepse shumë prej veprimeve të AAPSK-së lidhen drejtpërdrejt me procedurat penale dhe konfiskimin e pasurive.</p> <p>Sekuestrimi vendoset nga gjykata me kërkesë të prokurorit në zbatim të Ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar. AAPSK merr në administrim pasurinë pasi prokurori nxjerr urdhërin për ekzekutim dhe dërgon raport të hollësishëm, brenda 15 ditëve nga emërimi i tij për Kryeadministratorin dhe autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit, për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes së pasurisë së sekuestruar, duke njoftuar njëkohësisht prokurorin e çështjes, kur pasuria është sekuestruar me kërkesë të kësaj të fundit.</p> <p>Roli i AAPSK është administrativ -juridik -ekonomik, dhe jo hetimor.</p> <p>AAPSK ka hartuar dhe propozuar projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të</p>		
--	--	---	--	---	--	--

			<p>konfiskuara”, i ndryshuar. Ky projektligj ka synuar:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Zgjerimin e objektit të ligjit</b> duke përfshirë jo vetëm pasuritë e sekuestruara nga organet e drejtësisë, por edhe ato të konfiskuara nga pushteti vendor dhe organet administrative, përfshirë ndërtimet pa leje.</li><li>• <b>Përfshirjen e pasurive të reja</b> si kriptomonedhat (monedhat virtuale), duke përcaktuar rregulla të posaçme për administrimin e tyre.</li><li>• <b>Krijimin e Fondit të posaçëm për ndërtimet pa leje</b>, i dedikuar për zhvillimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara.</li><li>• <b>Transferimin e kompetencave të shitjes</b> së pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara tek vetë Agjencia, duke shmangur vonesat burokratike dhe duke rritur efikasitetin financiar.</li><li>• <b>Rritjen e kapaciteteve institucionale</b> për menaxhimin e ciklit të plotë të pasurisë, nga sekuestrimi deri në shitje dhe transferim të të ardhurave.</li></ul>	
--	--	--	---	--

		<p><b>Projektligji për ndryshime në Ligjin nr. 66/2023</b></p>		<p>Ky projektligj ka synuar të forcojë mbrojtjen e interesave publike dhe të sigurojë një administrim më të shpejtë, transparent dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara/konfiskuara.</p> <p>Në vijim të reformave, AAPSK ka hartuar dhe propozuar projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social”. Ky projektligj ka sjellë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Centralizimin e kompetencave</b> pranë AAPSK-së, duke e përcaktuar si organ unik përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e objekteve të konfiskuara.</li><li>• <b>Krijimin e Grupit të Punës</b> si strukturë e përhershme teknike për vlerësimin e gjendjes juridike, teknike dhe financiare të objekteve.</li><li>• <b>Ngritjen e Regjistrit të Objekteve të Konfiskuara</b>, për të garantuar transparencë dhe akses publik.</li><li>• <b>Thjeshtimin e procedurave ligjore dhe teknike</b>, përfshirë dhënien e lejeve të</li></ul>	
--	--	--	--	--	--

				<p>zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe rregullimin e procedurave të shitjes përmes ankandit publik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përcaktimin e qartë të përgjegjësiwe ligjore dhe financiare</b> të subjekteve zhvilluese, zbatuese dhe mbikëqyrëse pas konfiskimit.</li> <li>• <b>Krijimin e fondit të veçantë/të dedikuar për ndërtimet pa leje</b>, i cili siguron financimin e qëndrueshëm për përfundimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara.</li> </ul> <p>Ky projektligj ka adresuar problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, si fragmentimi i kompetencave, mungesa e transparencës dhe vështirësitë në financim, duke ofruar një model të ri të qartë, efikas dhe të qëndrueshëm.</p>		
2.	03.03.2026	Përhëndetje. Në vijim të komunikimit me ju si institucion dhe duke ju falënderuar për kthim përgjigjet e deritanishme jeni të lutur të më vendosni në dispozicion të dhënat sa vijon:	13.03.2026	<p>Përhëndetje, referuar kërkesës tuaj ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëlidhur gjeni tabelën me të dhënat përkatëse lidhur me listën e 1092 pasurive që nuk janë marrë ende në dorëzim nga Agjencia.</li> </ul>	Me email	Pa pagesë

	<p>1.Jeni të lutur të më nisni të detajuar listën e 1092 pasurive, provave, mjeteve motorike, pasuri të paluajtshme të pamarrë ende në dorëzim nga Agjencia, sipas zërave përkatës</p> <p>2.Çfarë vlere financiare kanë në total?</p> <p>3.Çfarë është vendosur me qytetarin e kërcënuar nga pronari për lirimin e ambientit të marrë me qira?</p> <p>4.Sa prej këtyre pasurive nën sekuestro/të konfiskuara janë të përfituara nga korrupsioni, shpërdorimi i detyrës apo tenderat?</p>		<p>-Këto pasuri nuk janë të vlerësuara financiarisht, pasi aktualisht nuk administrohen nga AAPSK.</p> <p>- Në lidhje me qytetarin e kërcënuar nga pronari për lirimin e ambientit të marrë me qira, pas referimit të rastit dhe ndërhyrjes së autoriteteve kompetente, palët kanë arritur mirëkuptim ndërmjet tyre dhe situata është normalizuar. Qytetari ka vijuar marrëdhënien e tij kontraktore me Agjencinë dhe nuk janë konstatuar episode të tjera të ngjashme.</p> <p>-Në lidhje me aktakuzat për pasuri nën sekuestro /të konfiskuara, që janë të përfituara nga korrupsioni, shpërdorimi i detyrës apo tenderat, bëjmë me dije Agjencia nuk ka në dispozicion informacion për pasuritë që ende nuk janë marrë në dorëzim.</p>		
	<p>Duke ju falenderuar përzemërsisht për ndihmën dhe bashkëpunimin që po tregoni, konfirmoj se e mora emailin. Por ndërkohë, në lidhje me pasuritë e pamarrë në dorëzim;</p> <p>1.Cilat janë propozimet që ka bërë Agjencia për të mundësuar marrjen e pasurive nën dorëzim?</p>		<p>Përsëritet,</p> <p>Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>1.Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në zbatim të detyrimeve ligjore, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për marrjen në dorëzim dhe administrimin e pasurive,</p>	Me email	Pa pagesë

		<p>2.Cilat janë arsyet e mosmarrjes në dorëzim të pasurive si rasti i aseteve të F.H dhe të E.M, apo mosmarrje në dorëzim të aseteve apartamente në Vlorë dhe Sarandë?</p>	<p>përfshirë bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse. Sqarojmë se Agjencia vepron vetëm mbi bazën e vendimeve gjyqësore të komunikuar zyrtarisht dhe të ekzekutueshme, dhe nuk ka kompetencë të propozojë marrjen në administrim të pasurive që nuk i janë kaluar ende.</p> <p>2.Në lidhje me mosmarrjen në administrim të pasurive të shtetasit F.H, sqarojmë se, me vendimin nr. 1532, datë 24.09.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 53, datë 20.03.2024 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këto kushte, në zbatim të këtij vendimi, pasuritë në fjalë nuk janë marrë në administrim nga ana e Agjencisë.</p> <p>Sa i përket pasurive të shtetasit E.M, rezulton se çështja është në proces verifikimi dhe ndjekjeje sipas procedurave ligjore përkatëse.</p> <p>Lidhur me pasuritë e tjera, sqarojmë se administrimi i tyre është i lidhur drejtpërdrejt me statusin juridik të vendimeve gjyqësore përkatëse. Në rastet kur vendimet janë të formës së prerë dhe nuk ekzistojnë pengesa ligjore për</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>ekzekutimin e tyre, Agjencia vijon me procedurat për marrjen në administrim të pasurive. Në të kundërt, në rastet kur ka vendime pezullimi apo procese gjyqësore në vijim, administrimi i këtyre pasurive nuk mund të realizohet deri në një vendimmarrje përfundimtare nga organet kompetente.</p> <p>Duke ju falenderuar për interesimin,</p>		
3.	08.04.2026	<p>Kërkesë për informacion publik mbi vendimmarrjen për zhvendosjen e mbetjeve të dyshuara si të rrezikshme- Nga Media Amfora</p> <p>Në vijim të një kërkesë për informacion drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga përgjigjja e kësaj të fundit rezulton se vendimmarrja dhe procedurat për zhvendosjen dhe ruajtjen e kontenierëve të sekuestruar me mbetje të dyshuara si të</p>	15.04.2026	<p>Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, paraqitur në bazë të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvendosja e kontenierëve në zonën e Shënavlashit është kryer nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në përputhje me ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, në kuadër të ushtrimit të funksioneve për ruajtjen dhe administrimin e këtyre pasurive.</li> <li>2. Vendimi për zhvendosjen e kontenierëve është mbështetur në aktin administrativ të datës 26.02.2026 të Autoritetit Portual Durrës, në të cilën është kërkuar</li> </ol>	Me email	Pa pagesë

	<p>rrezikshme në Durrës janë në kompetencë të institucionit tuaj. Në këtë kuadër, në bazë të ligjit për të drejtën e informimit, kërkojmë informacion mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kush ka marrë vendimin për zhvendosjen e kontenierëve në zonën e Shënavlashit?</li> <li>2. Në cilin akt administrativ mbështetet ky vendim (urdhër/vendim/shkresë) dhe cila është data e tij?</li> <li>3. Cilat institucione apo struktura kanë qenë të përfshira në këtë vendimmarrje?</li> <li>4. Cilat kanë qenë arsyet dhe kriteret për përzgjedhjen e kësaj zone për vendosjen e kontenierëve?</li> <li>5. Çfarë masash sigurie dhe monitorimi janë parashikuar për këto materiale gjatë qëndrimit në këtë zonë?</li> </ol>		<p>bashkëpunimi i institucionit tonë për lirin e hapësirës.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>3. Në këtë proces kanë qenë të përfshira edhe strukturat e Policisë së Shtetit, përfshirë Oficerin e Policisë Gjyqësore, në kuadër të garantimit të ligjshmërisë dhe sigurisë gjatë zbatimit.</li> <li>4. Përzgjedhja e zonës së Shënavlashit është bërë për arsye logjistike dhe operacionale, për shkak të afërsisë me vendndodhjen e zhvendosjes, aksesit të përshtatshëm për transport dhe mundësisë për të garantuar kushtet e nevojshme të sigurisë dhe administrimit.</li> <li>5. Gjatë qëndrimit në këtë zonë, kontenierët janë objekt i masave të vazhdueshme të sigurisë dhe monitorimit, duke përfshirë ruajtjen nga Policia e Shtetit, praninë fizike të strukturave përgjegjëse, si dhe mbikëqyrjen me sisteme kamerash sigurie.</li> </ol> <p>Ju faleminderit,</p>		
--	---	--	---	--	--